



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORE
KOMISIONI I EKSPERTIZËS

Nr. 22 prot.

Vlorë, më 10.01 2025

MIRATOHET

PREFEKTI

Kristo Kriço

VENDIM

Nr. 1 datë 10.01.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTEVE ME RËNDËSI HISTORIKE KOMBËTARE TË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT VLORE”

Në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, kreu 2, neni 7 dhe “Norma tekniko/profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 33, Komisioni i Ekspertizës për përcaktimin e vlerës së ruajtjes së dokumenteve të institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, ngritur me Urdhërin e Prefektit Nr.4, datë 08.01.2025, i mbledhur sot në datën 10.01.2025, pasi shqyrtoi listën e dokumentacionit të arkivit të Prefektit të Qarkut Vlorë:

VENDOSI

1. Të miratojë listën e dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare të Institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i kategorisë së dokumenteve	Afati i ruajtjes	Vrejtje
1.	Vendime Vendime për shkelje administrative, për masë disiplinore, për miratim të rregulloreve, etj.	RHK	
2	Urdhëra Urdhëra të Prefektit për komandim në detyrë, për lirimin nga detyra; për krijimin e Komisioneve; për fillimin e marrdhënieve financiare të nënpunësve të Prefekturës; për ngritjen e grupeve të punës në terren; për përballimin e situatave emergjente; për delegim kompetencash; për krijimin e komitetit Rajonal të luftës kundër trafikimit të personave; për monitorimin dhe kontrollin në zbatim të detyrave ligjore në kuadër të sezonit turistik, etj.	RHK	
3	Plane pune një dhe shumë vjeçare të institucionit të Prefektit. Raporte, Analiza dhe Informacione vjetore dhe shumë vjeçare.	RHK	
4	Shprehje ligjshmërie për vendimet e Këshillave Bashkiake dhe të Këshillit të Qarkut. Proces verbale të nënshkrimit të librave të vendimeve të Bashkive.	RHK	
5	Dokumente për monitorimin e Kompetencave dhe Funksionet e deleguara. Informacione, raporte një dhe shumë vjeçare për monitorimin në terren të turizmit, kanabisit, trafikimit të qënieve njerëzore.	RHK	
6	Konfirmime genplanesh për objektet e privatizuara nga subjektet.	RHK	
7	Plane pune; plane Masash dhe Bashkveprimi për përballimin e situatave emergjente. Evidenca, raporte vjetore.	RHK	
8	Dokumente për Financën, thesarin dhe bankën. Studime, bilance vjetore, relacione statistikore vjetore; prokurime me vlera të mëdha; tendera.	RHK	

9	Vendime dhe Proces verbale të Komisionit të Ekspertizës; regjistër korespondence; regjistër i dorzimit të dokumenteve nga sekretaria në sektor dhe anasjelltas. Proces verbale për marrje në dorëzim të dokumentacionit.	RHK	
---	--	-----	--

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse (Zyra protokoll/Arkiv).